



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



KURTI DORËZOHET, E FTON LDK-në NË NEGOCIATA

FAQE 4-5



Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, si duket është dorëzuar për ta formuar i vetëm qeverinë e re. Ai i ka dërguar një ftesë kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhikut, për

t'u takuar në lidhje me konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe për procesin e zgjedhjes së qeverisë së re, duke ia ofruar dy ditë dhe tri orare të ndryshme si opsione

për takim. Zyrtarët e LDK-së, kur janë pyetur të hënën nga mediet nëse do t'i përgjigjen ftesës së Kurtit, kanë theksuar se këtë të drejtë e ka vetëm Abdixhiku

**KALLASI:
JEMI DUKE
I ANALIZUAR
GABIMET E
DIALOGUT
KOSOVË -
SERBI**

F. 4-5



**KOMF-I, LETËR PARTIVE POLITIKE
PËR KRIJIMIN E MINISTRISË PËR
MIRËQENIE SOCIALE**

F. 7



**PARADOKSI I TREGUT
TË PATUNDSHMËRIVE: MBI
180 MIJË BANESA TË ZBRAZËTA**

F. 8

SPORT



**NEZIRI: DUKAGJINI KA MERITUAR
MË SHUMË PIKË**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Fruthi përhapet në 23 shtete amerikane, vdiq edhe një fëmijë

WASHINGTON, 7 PRILL - Dy fëmijë kanë vdekur deri tani në Teksas nga fruthi. Shpërthimi i kësaj sëmundjeje ka çuar në gati 500 numrin e rasteve dhe është përhapur në 22 shtete të tjera të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, thanë zyrtarët amerikanë.

Sekretari i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore, Robert F. Kennedy Jr., kundërshtar i kamotshëm i vaksinave i cili më parë kishte këmbëngulur se vaksinimi është zgjedhje personale, tha të dielën se vaksinat janë mbrojtja më e mirë kundër fruthit. "Mënyra më efektive për ta parandaluar përhapjen e fruthit është vaksina [kundër fruthit, shytave dhe rubeolës]", shkroi Kennedy në rrjetin social X.

Çfarë është fruthi?

Fruthi është një infeksion i shkaktuar nga një virus dhe, sipas OSH-së, është një prej sëmundjeve më ngjitëse. Ai shfaqet me skuqe në lëkurë - fillimisht me njolla në fytyrë

dhe pas veshëve, që më pas përhapen në gjoks dhe shpinë dhe në fund në këmbë. Simptomat tjera që e shoqërojnë fruthin, përfshijnë: temperaturë, koll të thatë, rrjedhje nga hunda, dhimbje të fytyrë e të tjera.

Infeksioni ndodh në faza, nga dy deri në tri javë. Fruthi mund të parandalohet me vaksinim, por, në raste të caktuara, mund të jetë edhe sëmundje serioze ose fatale.

Zyrtarët shëndetësorë në Teksas thanë se fëmija i dytë që humbi jetën është një vajzë 8-vjeçare e pavaksinuar, e cila nuk kishte sëmundje të tjera.

Ajo vdiq më 3 prill në spital nga dështimi frymëmarrjes i shkaktuar nga fruthi, thanë zyrtarët.

Një fëmijë tjetër në Teksas vdiq më herët pas përhapjes së fruthit, që nisi në fund të janarit në këtë shtet.

Fruthi ishte shpallur i eliminuar në Shtetet e Bashkuara nga viti 2000, por për raste të kohëpaskohshme me këtë sëmundje janë fajësuar



udhëtarët nga vende të tjera. Kennedy tha se ka 642 raste të konfirmuara me fruth, 499 prej tyre vetëm në Teksas.

Ai shtoi se ekupe nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) janë dërguar në Teksas me kërkesë të guvernatorit Greg Abbott.

Në të kaluarën, Kennedy kishte

rekomanduar vitaminën A dhe ushqimin e mirë si trajtim për fruthin.

Studimet në disa vende në zhvillim kanë treguar se vitamina A mund ta zvogëlojë ashpërsinë e simptomave, por gjithashtu mund të shkaktojë toksicitet në mëlçi nëse merret në sasi të larta.

Shumë demokratë e

kundërshtuan emërimin e Kennedyt - djali i senatorit të ndërë Robert F. Kennedy dhe nipi i presidentit John F. Kennedy - për shkak të teorisë së tij të pazakonta për shëndetin, përfshirë qëndrimin e tij kundër vaksinave.

Zyrtarët kanë thënë se vaksina kundër fruthit është 97 për qind efektive pas dy dozave.

Në faqen e saj të internetit, CDC-ja thotë se vaksina është "mbrojtja më e mirë kundër fruthit", i cili përhapet nëpërmjet ajrit kur një person i infektuar teshtin apo kollitet.

Deri tani këtë vit numri i rasteve me fruth në Shtetet e Bashkuara është dyfish më i madh se tërë viti ne kaluar.

Përveç Teksasit, shtetet me raste aktive - me tri ose më shumë raste - janë Nju Meksiko, Kansas, Ohajo dhe Oklahoma. Kjo sëmundje përhapet në zona me nivel të ulët të vaksinimit. Organizata Botërore e Shëndetësisë tha javën e kaluar se rastet me fruth në Meksikë janë të lidhura me ato në Teksas.

Tarifat "godasin" bitcoinin. Evropa e pëson më keq, 890 miliardë euro humbje brenda tri orëve



WASHINGTON, 7 PRILL - Tarifat e vendosur me aq ngazëllim prej tij kanë goditur edhe sektorin e kriptomonedhave, të cilin vetë Donald Trump e inkurajoi me forcë në fillim të marsit kur mblodhi në Shtëpinë e Bardhë drejtues të tij për të diskutuar mbi investimet digjitale dhe objektivin e vet të ngritjes së një rezervë strategjike për monedhën bitcoin.

Tani vlera e kriptomonedhave ka pësuar një rënie të ndjeshme në Azi, duke sinjalizuar një ndjenjë të qartë rreziku në të gjithë tregjet. Sipas medieve të huaja,

bitcoin humbi rreth 7 për qind të vlerës së tij mbrëmjen e së dielës deri mëngjesin e sotëm në Singapor duke mbërritur një pikë të ulët prej 77,077 dollarë.

Ether, po ashtu, ra në 1,538 dollarë, nivel më i ulët brenda ditës i regjistruar ndonjëherë që nga tetori i 2023. Si bitcoin ashtu edhe Ether më vonë i "zvogëluan humbjet". Tarifat gjithëpërfshirëse të Trumpit tashmë kanë "fshirë" trilionat dollarë në vlerë nga aksionet amerikane. Politika e re e Uashingtonit vendos një tarifë prej 10% për shumicën e importeve, me norma edhe më

të larta për vende specifike, si 34% për importet kineze dhe 20% për mallrat e BE-së.

Tregjet financiare janë alarmuar nga lëvizja agresive dhe investitorët po përgatiten për paqëndrueshmëri të zgjatur ekonomike.

Evropa tashmë ka nxjerrë thuajse 890 miliardë tym në pak më pak se 3 orë tregtimi. Ky është bilanci provizor i seancës së sotme me indeksin Stoxx 600 të rënë me 5.86%. Duke parë listat e çmimeve individuale, Milano humbet 6.17%, Frankfurt 5.68%, Parisi 5.56%, Madridi 5.33% dhe Londra 4.52%.

Gjermania nuk kryeson më renditjen e BE-së në kërkesat për azil

BERLIN, 7 PRILL - Sipas raportit të fundit të Komisionit të BE-së, Gjermania nuk është më kryesuesja e BE-së në aplikimet për azil për herë të parë në vite. "Welt am Sonntag" citoi raportin e 2 prillit 2025, të konsideruar si konfidencial, mbi situatën e migrimit në BE dhe vendet e treta.

Vendin e parë në aplikimet për azil aktualisht e mban Franca me 40.871 kërkesa të regjistruara për azil nga 1 janari deri më 31 mars të këtij viti. Pastaj renditet Spanja (39.318 kërkesa për azil) dhe e treta Gjermania.

Në Gjermani, numri i kërkesave për azil ka rënë me 41 për qind në tremujorin e parë të këtij viti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ku kishte 37.387 aplikime. Në fund të renditjes së BE-së gjenden Hungaria me 22 kërkesa për azil dhe Sllovakia me 37 kërkesa.

Sipas raportit të "Welt am Sonntag", një e katërta e të gjitha aplikimeve për mbrojtje në Gjermani bëhen nga sirianë (24 për qind), të ndjekur nga afganët (16 për qind) dhe turqit (11 për qind). Franca është bërë vendi numër një i destinacionit

për ukrainasit.

Sipas raportit, shumica e atyre që kërkojnë mbrojtje në BE, si dhe Zvicër dhe Norvegji, erdhën nga Venezuela, të ndjekur nga azilkërkuesit nga Afganistani dhe Siria. Në përgjithësi, numri i kërkesave për azil nga venezuelasit u rrit me 44 për qind në tremujorin e parë të këtij viti. Kërkesat për azil nga ukrainasit, kinezët dhe indianët gjithashtu u rritën ndjeshëm. Në të kundërt, dukshëm më pak njerëz nga Siria, Kolumbia dhe Turqia kanë aplikuar për azil gjatë kësaj periudhe.



KALLASI: JEMI DUKE I ANALIZUAR GABIMET E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

PRISHTINË, 7 PRILL - Bashkimi Evropian është duke i zërthyer gabimet në dialogun e Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë në mënyrë që t'i japë gjallëri procesit të normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve fqinje, tha të hënën në Podgoricë shefja e politikës së jashtme të bllokut, Kaja Kallas. E pyetur për ngecjen e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kallas tha gjatë një konference për medie se "ajo çfarë po bëjmë këtë muaj është analizimi" së bashku me të dërguarit e BE-së për dialogun, Peter Sorensen, i cili e mori detyrën në shkurt. "Për ne është me rëndësi normalizimi i marrëdhënieve, sepse pa to asnjëra nga nuk mund të ecë përpara në rrugën drejt BE-së", tha Kallasi.

Kallasi nuk dha më shumë hollësi se cilat mendon që ishin gabimet apo çfarë nuk ka shkuar deri tani në dialogun e ndërmjetësuar nga blloku. Me gjithë dialogun e zhvilluar ndër vite dhe nënshkrimin e marrëveshjeve, procesi ka

ngecur dhe tensionet janë rritur. Me ndërmjetësimin e BE-së, në vitin 2023 Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve. Por, prej atëherë, blloku i ka kritikuar ato të dyja vendet se nuk e kanë zbatuar marrëveshjen pavarësisht se ajo është e detyrueshme për to.

Kallasi, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" më 2 prill, ka thënë se Bashkimi Evropian është i interesuar për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, qoftë përmes dialogut apo ndonjë instrumenti tjetër. "Ndoshta është dialogu, ndoshta është një tjetër mjet. Jam e gatshme ta shqyrtoj këtë çështje, dhe do ta bëj këtë së bashku me përfaqësuesin e Posaçëm [për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen] në ditët në vijim", kishte thënë Kallasi.

Për shkak të krizave në veriun e Kosovës, që rritën tensionet mes dy vendeve, që nga shtatori i vitit 2023 në Bruksel nuk është



zhvilluar asnjë raund i dialogut politik, por ka pasur vetëm bisedime në nivel të kryenegociatorëve.

Përfaqësuesja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, nga 7 deri më 9 prill është duke vizituar disa shtete

në Ballkanin Perëndimor. Në vizitën e parë të saj në rajon si shefe e diplomacisë evropiane, Kallas do të qëndrojë në Mal të Zi, Shqipëri dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Ajo nuk paralajmëruar t'i vizitojë Kosovën dhe Serbinë. Të gjashtë vendet e Ballkanit

Perëndimor - përveç Kosovës - si dhe Ukraina, Moldavia, Gjeorgjia dhe Turqia janë kandidatë për anëtarësim në BE.

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në bllokun evropian, por aplikimi i saj nuk është shqyrtuar ende.

OSMANI BISEDON ME PRATTIPATIN PËR SIGURINË NË KOSOVË

PRISHTINË, 7 PRILL - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur sot në takim të ngarkuarën me Punë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Anu Prattipati. Në takim u diskutua për zhvillimet e fundit në vend, përfshirë situatën e sigurisë në Kosovë dhe në rajon.

Duke folur për situatën e sigurisë dhe zhvillimet në këtë sferë, presidentja Osmani theksoi tendencat e vazhdueshme të Serbisë për destabilizimin e Kosovës dhe të të gjithë rajonit përmes veprimeve të mirëkoordinuara me struktura ilegale dhe banda kriminale serbe.



Osmani ka diskutuar me Prattipatin për arrestimin e qytetarëve serbë në Gjakovë dhe në Prizren, të cilët

pretendonin se ndodheshin në pelegrinazh. Porse, hetimet e deritashme kanë treguar se këto grupe kishin

ndërlidhje me strukturat e inteligjencës ushtarake serbe si dhe me anëtarë të grupit terrorist të Banjskës.

Presidentja theksoi se ky veprim është pjesë e një përpjekjeje të vazhdueshme nga Serbia për destabilizimin e Kosovës përmes kërcënimeve dhe dhunës.

Sipas presidentes, kjo përbën një ndërhyrje të papranueshme në sovranitetin shtetëror të Republikës së Kosovës.

Më tej, presidentja Osmani dënoi me vendosmëri këto veprime destabilizuese dhe të papranueshme, duke theksuar se Kosova nuk do të tolerojë asnjë ndërhyrje që

rrezikon paqen, rendin kushtetues dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve të saj, pa dallim përkatësie.

Ajo i falënderoi të gjitha institucionet e sigurisë për punën në mbrojtje të vendit dhe diskutoi me Prattipatin rreth bashkëpunimit të vazhdueshëm me ShBA-në në këtë drejtim.

Presidentja e njoftoi Prattipatin edhe për hapa të tjerë konkretë që do të ndërmarrë, brenda kompetencave të saj kushtetuese, për ta thelluar aleancën strategjike me ShBA-në dhe për ta mbrojtur interesin e Republikës së Kosovës.

AIP MBLEDH 14 SHTETE PËR TA PROMOVUAR LIRINË E INFORMACIONIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PRISHTINË, 7 PRILL - Nën përkujdesjen e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, për herë të parë në Kosovë ka filluar punimet Punëtorisë Ndërkombëtare për Lirinë e Informacionit, një ngjarje që mbledh ekspertë dhe përfaqësues të Autoriteteve për Qasje në Dokumente Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale e të Dhënave Personale nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Austria, Zvicra, Portugalia, Spanja, Skocia, Zyra e Avokatit të Popullit Evropian, Kroacia, Hungaria, Sllovenia, Mali i Zi,

Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Pjesëmarrësit do të shkëmbejnë përvoja dhe praktika më të mira, duke theksuar rëndësinë e transparencës në shpenzimin e parasë publike dhe prokurimin publik, sekretet afariste dhe çështjet e pronësisë intelektuale.

Punëtorinë dyditore ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës dhe shteteve ndërkombëtare dhe të rajonit për të siguruar një qasje më të hapur dhe efikase të informacionit dhe për t'i

përmirësuar dhe forcuar mekanizmat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Punëtorinë Ndërkombëtare për Lirinë e Informacionit shënon një ngjarje historike për promovimin e lirisë së informacionit në Kosovë dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e lirisë së informacionit që do të na shërbejnë në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në Republikën e Kosovës.





KURTI DORËZOHET, E FTON LDK-në NË NEGOCIATA

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, si duket është dorëzuar për ta formuar i vetëm qeverinë e re. Ai i ka dërguar një ftesë kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhikut, për t'u takuar në lidhje me konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe për procesin e zgjedhjes së qeverisë së re, duke ia ofruar dy ditë dhe tri orare të ndryshme si opsione për takim. Zyrtarët e LDK-së, kur janë pyetur të hënën nga mediet nëse do t'i përgjigjen ftesës së Kurtit, kanë theksuar se këtë të drejtë e ka vetëm Abdixhiku

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 PRILL - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i ka dërguar një letër kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhikut, me të cilën e fton për konsultime para konstituimit të Kuvendit. Nuk dihet nëse të njëjtën letër ua ka dërguar edhe partive të tjera. Kurti i ka kërkuar Abdixhikut takim këtë javë, duke ia ofruar dy ditë dhe tri orare të ndryshme si opsione për takim. “Me qëllim të konstituimit të plotë të Kuvendit të Republikës së

Kosovës dhe procesit të zgjedhjes së Qeverisë së re, për t'u konsultuar paraprakisht, ju ftoj në takim të mërkurën, me datë 9 prill, në orën 15:00, apo të enjten, me datë 10 prill, në orën 9:00 ose në 14:00”, thuhet në letrën që Kurti ia ka dërguar Abdixhikut. Kurti shkruan në fund të letrës se e mirëpret përgjigjen e Abdixhikut për këtë takim. Seanca konstituive e Kuvendit do të mbahet më 15 prill, siç ka vendosur presidentja Vjosa Osmani. Po atë ditë LV-ja synon ta zgjedhë edhe qeverinë, siç ka deklaruar më herët Kurti. LDK-ja në zgjedhjet e 9

shkurtit ka fituar 20 mandate në Kuvendin e Kosovës. Zyrtarët e kësaj partie, kur janë pyetur të hënën nëse do t'i përgjigjen ftesës së Kurtit, kanë theksuar se këtë të drejtë e ka vetëm Abdixhiku. Gani Geci nga LDK-ja e ka komentuar këtë ftesë të Kurtit për Abdixhikun. Ai ka thënë se tani për LDK-në janë pajtuar të gjithë në Kosovë se kjo parti e ka pasur programin më të mirë parazgjedhor nga të gjitha partitë. “Andaj mendoj se LDK-ja duhet t'i tregojë LV-së se nuk di të qeverisë, nuk di të bëjë program, nuk di të krijojë ura miqësie as me ndërkombëtarët as me shqiptarët, prandaj LDK-ja duhet të insistojë që të inkorporohet në përgjithësi programi i LDK-së. Të rritet koeficienti 150 euro që në javën e parë dhe të zbatohet në tërësi programi parazgjedhor i LDK-së, dhe pastaj të flasin për ndarje pushtetesh”, ka shkruar Geci në “Facebook”. Kandidati i Nismës për deputet, Zafir Berisha, ka reaguar pas ftesës që Albin Kurti i ka dërguar të parit të LDK-së, Lumir Abdixhiku, për

takim para seancës së konstituimit. Berisha këtë ftesë e ka quajtur “djallëzore”. “Pas deklaratave të djeshme se Serbia po e pengon në bërjen e qeverisë, tash po kërkon nga ‘hajvanat’ me i thënë jo, për me i radhit sipas logjikës së tij mashtruese, në anën e Serbisë. Jo rastësisht i ka bërë ftesë fillimisht LDK-së, votuesit e saj janë target në zgjedhjet e jashtëzakonshme që po e përgatitë për ta çuar Kosovën”, ka shkruar Berisha në “Facebook”. Edhe ish-anëtari LV-së, tash pjesë e AAK-së, Haki Abazi, ka reaguar pas ftesës që Kurti i ka bërë Abdixhikut. Ai në “Facebook” e ka krahasuar Kurtin me “majtistët jugosllavë”. “Majtistët jugosllavë kërkojnë bashkëpunim kur u bëhen pick, dhe atë për të mbajtur afër dhe në mundësinë e parë ta fusin thikën në shpinë! Sa më larg Kurtit aq më afër demokracisë!”, ka shkruar Abazi. Kurti deri para kësaj letre ka thënë disa herë se ai do ta udhëheqë qeverinë, pavarësisht se LDK-ja ka tashmë qëndrim se hyjnë në

koalicionë vetëm nëse Abdixhiku drejton qeverinë. Kjo mbetet të shihet deri më 15 prill se si do të rrjedhin gjërat. Kurti javën e kaluar i ka takuar liderët e partive politike të pakicave, nga të cilët ka marrë mbështetje për formimin e qeverisë së re. Lëvizja Vetëvendosje është fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit me 42.27 për qind të votave të fituara apo 48 ulëse në Kuvendin me 120 vende. Kjo nënkupton se kjo parti nuk mund ta formojë e vetme ekzekutivin e ri, për të cilin duhen 61 deputetë. Sipas rezultateve përfundimtare, PDK-ja ka 24 mandate dhe koalicioni AAK-Nisma 8 mandate. Kryetari i legjislaturës së kaluar, Glauk Konjufca, do të takohet të martën me të gjithë liderët politikë para seancës konstituive të 15 prillit. Takimi do të mbahet në ndërtesën e Kuvendit dhe do të fokusohet vetëm në një pikë të rendit të ditës: “Përgatitjet për seancën konstituive të legjislaturës IX të Kuvendit të Republikës së Kosovës”.

LUFTË E EGËR PËR PUSHTET E JO PËR SHTET



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Sulmi nga varret politike: Ndonëse kaluan më shumë se dy muaj nga zgjedhjet e fundit, ende nuk është formuar asnjë institucion. Të gjithë po blejnë kohë, pa para, madje paguhen shumë mirë për punën që nuk e bëjnë apo edhe për bllokimet që i bëjnë. Presidentja e Kosovës, Vojsa Osmani në një pushim disaminutësh të ndërrimit të aeroplanit caktoi 15 prillin ditën kur do të funksionalizohet Kuvendi i Kosovës e që është brenda afateve të parapara me ligj. KM i Kosovës, Albin Kurthi nisi takimet me partitë më të fuqishme në Kosovë për formimin e institucioneve. Gjithashtu u takua me individë të fuqishëm e të pazëvendësueshëm, të njohur për angazhim të përhershëm dhe të pamohueshëm politik dhe patriotik, siç janë irredentisti nga Livaxha, Nenad Rashiq, Amazona nga Prizreni, Emilly Bronte Rexhepi, Faraoni nga Peja apo alter ego i Kaçketës, Elbert Krasniqi, Supermeni nga Prizreni, Fikrim Damka dhe disa jeniçerë të Erdoganit. Të gjithë këta e kënduan para Kurthit këngën “Besa - besë, besën ta kem dhënë, se për Turqinë, Serbinë dhe Egjiptin, jetën kem me e dhanë....”. Thonë se Kurthi jo vetëm u përlotë por ra në trans nga besnikëria e këtyre përfituesve të posteve dhe privilegjeve në të gjitha qeveritë dhe regjimet në Kosovë, që nga përfundimi i luftës. Petalja kryesore e tërfillit fatsjellës ishte Adem Hodza nga Lista Serbe që shërbeu si xhoker në të gjitha regjimet dhe qeveritë duke e bërë të lumtur edhe Vojsa Osmanin me votën që u bë presidente. A do ta bëjë të lumtur edhe Albin Kurthin duke e votuar për KM të Kosovës? Them se po, edhe Kurthin sikur edhe zemlaken e Radoiqiqit, “zonjën” Limoza Kulari - Gadafi. Adem Hodza ishte hapareshtë në zyrën e uzurpuar nga Kurthi si të ishte vet Ymer Prizreni. Kurthi

dukej i vogël, sigurisht nga modestia. Kur Kurthi ka nevojë për dikë apo diçka, shndërrohet në mizë, kur e shliron prapanicën, bëhet balenë apo elefant. Shkelë çdokënd apo çdo gjë që i del përpara, ata që e kanë ndihmuar apo përkrahur, i shkelë të parët e që është në përputhje me vlerat më të larta morale. Rregullat e Gottit - Morali i Kurthit! Se Kurthi është largpamës në politikë dhe në edukatë seksuale tregon fakti se nuk i ftoi fare për konsultime partitë e minoriteteve, PDK-në, LDK-në dhe AAK-në. Si e parasheh ligji për diskriminim pozitiv, e ftoi kryetarin e Nismës për Malishevën, Fatmir Limën, jo në zyrë por sipas disa mediave, në një restaurant për një darkë pune. Disi si Darka e Judës. Pas kësaj, njeriu me trupin më të madh në LV e që nuk mund të thuhet e njëjta edhe për trurin, tha se e pati puna e qeverisë, falë Limës që për ta marrë Malishevën e brenë edhe hekurin. Pastaj, edhe kumbara i spasiqëve të Obiliqit, kriminelë luftime, i cili për shkak të gjenialitetit politik përsëri është bërë deputet, tha publikisht se Kurti do të jetë kryeministër, Glauk Bin Sherifi, kryetar i Mexhllisit sikur që edhe të tjerët do t'i kenë postet e njëjta, në bazë të meritokracisë dhe integritetit profesional të munguar. Në fund të fundit kush mund të zëvendësojë Donikë Katran Shvarcin, manikenen Lenka Çukon që ka bërë aq shumë reforma në fushën e dizajnit, floktarisë dhe manikyr - pedikyr. Apo Hajnrullahun, paramilitarin e Financave, Parazitin e Shëndetësisë, Sherlock Kaçket Holmsin, Cen Mishin dhe të tjerë me të cilët, me plotë të drejt m(b)urret Çlirimtari i Shtëmës që fort bindshëm, në jetën e përditshme po e përditëson rolin e Jack Nikolsonit në filmin “Fluturimi mbi follenë e qyqes”. Haxhi Qamili nga Pz, në paranojën e

certifikuar legjendare po thotë se serbët e arrestuar në Jakovë dhe Perzeren kanë pasur qëllim që përmes luftës hibride (pordhëve dhe barutit) kanë ardhur ta rrëzojnë Albin Kurthin dhe ta rikthejnë në pushtet opozitën! Ese thuaj këtij hajvan, sipas kriterëve të Kurthit. Është doppio hajvan. Po ta lëmë këtë humor të Zi e t'i kthehemi realitetit, që gjithashtu është i zi, katan i zi.

Kosova, në bisht të sorrës: Kosova asnjëherë nuk ka qenë më keq në planin ndërkombëtar, nga një i llastuar, jemi krejtësisht të harruar! E kemi filluar, me Kurthin dhe në krye me Kurthin (KM e kemi), luftën brenda llojit, midis kosovarëve dhe shqiptarëve, për vota, poste dhe pushtet, duke mos menduar fare për shtet. Sa i përket Amerikës politikisht thuaja jemi me Iranin. Evropa na i ka futur sanksionet. Kina nuk na respekton fare fuqinë politike dhe ekonomike. Me aleatin Ukrainën që nuk na njehë si shtet, po e humbim luftën kundër Rusisë. India as pambuk nuk po na shet. Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin i dorëzuan në Hagë, tash i fërkojmë duart duke lutur zotin Kurthi të mos lirohen, në Maqedoni të Veriut ia futëm Aliut të UÇK-së e po ia kruajmë Bekim Koçes të Kurthit, në Luginë u bëmë lesh që na lënuar Serbia, Brazili po na shet mish ku 30 për qind janë krimba, 30 për qind janë salmonelë dhe 40 për qind mbetje të mishit. Hungaria na ka ndaluar gullashin, Mali i Zi na ka marrë “shqiptaromadhin” Abazoviqin etj.

Donald Tramp i ka prishur të gjitha rregullat e lojës, nuk tregon se kur dhe si ta ngulë. Si asnjëherë më parë, Serbia në planin ndërkombëtar është 100 për qind më mirë se Kosova. Në kohën kur Vuçiq do të shkon në takim me Trampin, Albin Kurthi

pret në takime të rëndësishme të jashtëzakonshme, Dilmal Bashën dhe Dezhona Mihalidis. Madje, më as gjyshi Dendias nuk po e thërret në Greqi në seancat e thekjeve të topeve që Albini e pati shndërruar në rutinë dhe ritual. Në këto rrethana kur askujt nuk i kujtohet se është një vend i quajtur Kosovë dhe se Kosova nga një partner i besuar në tavolinë të bisedimeve është shndërruar në pjesë të menysë në tavolinat e hijenave, dhe kur neve mund të na lënë një asht për ta lëpirë duke e ushqyer Serbinë me mishin tonë, Albin Kurthi po i del ballë këtyre sfidave dhe hijenave me shpurën analfabete, antikombëtare të cilët, pjesa më e madhe nuk e ka asnjë kontribut personal apo familjar. Luftë apo më mirë ta them është pordhë e Don Kishotit. Me këta “mashqi të lodhur”, Albin Kurti me shpejtësi po largohet nga Shqipëria dhe po afrohet - mvaret nga Serbia! E pastaj po ankohet se Vuçiqi po i bënë hajmali apo magji me deputetë serbë dhe pakica joserbe! Nuk po e lë t'i formojë institucionet, të bëhet kryeministër etj. Po ky e pati çliruar Kosovën, pati integruar serbët, e mendi Serbinë, e shtriu sofrabezin e sovranitetit. E pse po ankohet tani?! Po e thërret Këshillin e Sigurisë Kombëtare për të bërë presion psikologjik, për asgjë tjetër. Për të marrë ndonjë votë përmes kërcënimit apo mashtrimit emocional. Po ta kishte përnjëmend do të ftonë PDK-në, LDK-në dhe AAK-në për të ndërtuar një skuadër që do të luante sipas interesit kombëtar dhe shtetëror. Para atyre që imponojnë dhe marrin vendime do të dukej më serioz, do të pranohej dhe trajtohej me më shumë respekt. Duke lënë anash PDK-në, LDK-në dhe AAK-në dhe duke luajtur me lojtarë si nenada, elberta, fikrima, emilija, rasima, do të përfundojë në moçal dhe kanalizim, të historisë,

kombëtar, politik, njerëzor dhe moral. Fatmir Limaj mund ta ndihmojë Kurthin ta bëjë qeverinë kurse Kurthi mund ta ndihmojë Fatmir Limën që Malishevën ta bëjë kryeqytet politik të Limajt gjë që Fatmiri ketë edhe e kërkon. Më shumë ka interes Limaj ta marrë Malishevën për 4 vjet se të bëhet kryetar i Kuvendit apo zëvendësues i Hysen Durmishit. Kuvendi dhe qeveria mund të shpërndahen para përfundimit të mandatit kurse mandati i udhëheqjes së komunës është 4 vjet. Aspak nuk e besoj sikur që nuk e besojnë as Kurthi dhe Limaj se shtrirja e tyre në shtratin e quajtur Kosovë bëhet për shkaqe kombëtare apo për shtet. Ekskluzivisht bëhet për pushtet. Qeveria e pakicës Kurthi 3, vetëm me minoritete dhe minorenin politik Limaj nuk vlen as për pesë para sikur që të njëjtin mendim e ndajë për qeverinë e pakicës që do ta formonte opozita. Asgjë e hajrit nuk del nga qeveritë e pakicave. Prandaj këmbëngul në një konsensus politik dhe kombëtar për formimin e qeverisë për një kohë të caktuar, deri sa të bëhet një zgjidhje përfundimtare për Kosovën. Në këtë rast nuk do të jetë nevoja as të blihen deputetët, as të luten pakicat destruktive, as t'i nënshtrohet shantazhit etj. Ndarja e pushtetit do të bëhej: LV-ja do të udhëhiqte qeverinë me Kurtin apo kënd të duan KM kurse PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja do të ndanin udhëheqjen e Kuvendit dhe presidencën. Pasi të kenë përfunduar procesi do të shpallëshin zgjedhjet dhe vota do të përcaktonte pastaj udhëheqjen e re. Kjo është e vetmja mënyrë që të shpëtohet çka mund të shpëtohet, të përballohen vendimet e vështira dhe të dhimbshme siç e përsërisin gjatë çdo takimi vendimmarrësit ndërkombëtar. Çdo veprim tjetër është batakçillëk, mujshari impotente dhe luftë donkishotiane, jo për shtet, por për pushtet!

KOSOVA NDALON 16 SERBË, REAGON BEOGRADI



PRISHTINË, 7 PRILL - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, njoftoi se autoritetet kanë ndaluar 16 persona, duke thënë se në mesin e tyre kishte edhe “oficerë aktivë të shërbimeve të sigurisë të Serbisë”.

Ndërkaq, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se personat e ndaluar po vizitonin manastiret përreth Prizrenit. Në “Facebook”, Sveçla se ndalimi i tyre u bë gjatë një operacioni të zhvilluar më 5 dhe 6 prill, duke shtuar se të ndaluarit po udhëtonin me katër automjete të ndara me targa nga Kragujevci, qytet në Serbi.

Grupi i parë, sipas tij, i përbërë nga katër persona, u ndalua në Gjakovë. Ndërkaq, 12 persona të tjerë u ndaluan në Prizren. “Sipas të dhënave fillestare, dyshohet se këto grupe kishin për qëllim mbledhjen e informacioneve për caqe të mundshme, pasi janë gjetur dëshmi të ndërlidhjes me strukturat e inteligjencës ushtarake serbe si dhe me anëtarë të grupit terrorist të Banjskës”, ka shkruar Sveçla.

Sipas tij, grupit të parë të ndaluar në Gjakovë, ndal të cilëve është shqiptuar masa e ndalimit prej 48-orësh, gjatë kontrollit të makinës me të cilin po udhëtonin, iu gjetën “fotografi me hartën e Republikës së Kosovës, fotografi të terroristëve të vrarë gjatë sulmit në Banjskë,

dy thika, një sëpatë dhe një dritë rotative”.

Për ndalimin e katër personave në Gjakovë ka raportuar edhe Policia e Kosovës, por edhe në njoftimin për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të mbajtur të dielën, është përmendur ky rast.

Ministri në detyrë, Sveçla, pretendoi se 12 personat e ndaluar në Prizren “po strehoheshin në Seminarin Ortodoks të Bogosllavisë”. “Edhe në këtë grup ishin dy oficerë aktivë të shërbimeve të sigurisë serbe”, u shpreh Sveçla.

Në anën tjetër, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se personat e ndaluar kishin shkuar për ta vizituar Seminarin Teologjik dhe manastiret përreth Prizrenit. “Imagjinoni, disa nga këta persona janë edhe pjesëtarë të strukturave të sigurisë, dhe pastaj u kanë gjetur, thonë, një thikë dhe një sëpatë të thyer - është krejtësisht e qartë se nuk shërbejnë për asgjë tjetër, përveç për ndonjë përdorim privat dhe nevoja personale”, u shpreh Vuçiqi më 6 prill. “Dhe kjo ju tregon çfarë terrori po vazhdon ndaj serbëve”, shtoi ai.

Udhëheqësi i Ministrisë së Brendshme të Kosovës deklaroi se bazuar në hetimet paraprahe të organeve të rendit të Kosovës, një nga të ndaluarit është “konfirmuar se është zyrtar i policisë serbe me gradë të togerit

policor”, i cili, siç pretendoi Sveçla, “ka lidhje të afërta familjare me anëtarin e grupit terrorist të Banjskës, Nemanja Radivojeviq, nofka ‘Gandi’”. “Ky i fundit është i afërt i Vlladimir Radivojeviq, nofka ‘Mami’, i cili është i dyshuari kryesor për vrasjen e rreshterit policor të Kosovës, Afrim Bunjaku. Zyrtari tjetër ushtarak, i cili bart gradën e kapitenit të klasit të parë, është lidhje e ish-gjeneralit të inteligjencës ushtarake serbe, Jovan Millanoviç, i njohur për përfshirjen në rrjedhjen e të dhënave të NATO-s para bombardimeve mbi caqet serbe”, tha Sveçla.

Emri i Vlladimir Radivojeviqit është përmendur edhe më herët nga autoritetet e Kosovës dhe është lidhur me sulmin në Banjskë të Zveçanit kundër Policisë së Kosovës, të kryer në shtator nga një grup i serbëve të armatosur.

Më 29 shtator të vitit 2023 Policia e Kosovës e bastisi shtëpinë e Radivojeviqit në Zveçan. Ai besohet se është udhëheqës i një grupi tifozësh të klubit të futbollit Crvena Zvezda.

Bastisjet në shtëpinë e Radivojeviqit ishin kryer në aksionin e njëjtë policor, kur u bastisën pronat e Millan Radoiçiqit, ish-nënkryetarit të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit.

Radoiçiqi ka marrë përgjegjësinë për organizimin dhe pjesëmarrjen në sulmin në Banjskë të Zveçanit, kur u vra polici Afrim Bunjaku. Gjatë këmbimit të zjarrit në Manastirin e Banjskës u vranë edhe tre sulmues serbë. Sipas Zveçlës, fakti që grupi i dytë - që u ndalua në aksionin e fundit - ishte “strehuar në Seminarin Ortodoks të Bogosllavisë mund të tregojë për një tentativë për të shfrytëzuar institucione fetare për kamuflim ose për të shkaktuar tensione ndëretnike/ fetare në Kosovë, duke përdorur ngjarje të sajara për të nxitur reagime të dhunshme ose trazira”.

Por, ky pretendim i Sveçlës është kundërshtuar nga Dioqeza e Rashkës dhe Prizrenit. Dioqeza tha se nga mediet ka mësuar se persona që natën paraprahe kanë qenë mysafirë të Seminarit, duke theksuar se Kisha nuk mund të ketë njohuri se kush janë të gjithë pelegrinët që marrin pjesë në shërbesa apo edhe në këtë seminar. “Çdo insinuatë se personat e përmendur, duke qëndruar në pjesën e mysafirëve të Seminarit, kinse kanë shfrytëzuar ‘institucionin fetar për maskim dhe për nxitje të tensioneve ndëretnike dhe fetare në Kosovë’, siç thuhet në komunikatën e sotme të Policisë së Kosovës, është krejtësisht e papërgjegjshme dhe nuk

bazohet në fakte konkrete”, tha Dioqeza e Rashkës dhe ajo e Prizrenit.

Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë përshkallëzuar qysh në prill të vitit 2023, kur u zgjodhën kryetarët e rinj shqiptarë të katër komunave në veri, të banuara me shumicë serbe. Zgjedhja e tyre nxiti protesta nga serbët lokalë.

Tensionet kulmuan shtatorin e atij viti, me sulmin e armatosur në Banjskë, që Kosova e konsideron sulm terrorist.

Në Kosovë është ngritur aktakuzë në rastin e Basnjës kundër rreth 40 personave, përfshirë edhe Millan Radoiçiqin. Besohet se ai dhe shumica e pjesëtarëve të grupit ndodhen të lirë në Serbi, ndërsa në paraburgim në Kosovë ndodhen Vladimir Toliq, Bllagoje Spasojeviq dhe Dushan Maksimoviç. Ata janë arrestuar pas sulmit në Banjskë, ndërsa seanca e parë në rastin e tyre do të mbahet më 17 prill.

Edhe Serbia po heton sulmin në Banjskë, por deri më tani nuk është ngritur asnjë aktakuzë.

Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar ashpër këtë sulm dhe ka kërkuar që pjesëmarrësit të përballen me drejtësinë.

Po ashtu, vitin e kaluar kanali i Ibër-Lepencit në veri u sulmua me mjete plasëse. Për këto dy sulme, Kosova ka fajësuar Serbinë, por Beogradi ka mohuar se ka gisht në to.

Komuna e Gjilanit mbështeti të rinjtë dhe gratë në biznes me rreth gjysmë milioni euro

GJILAN, 7 PRILL - Edhe sivjet komuna e Gjilanit do t'i mbështesë sipërmarrësit e rinj dhe gratë me 150 mijë euro përmes fondit për ndërmarrësit.

Idetë e të rinjve dhe grave në biznes janë financuar për herë të parë nga kjo

qeverisjeje nga viti 2023, pastaj edhe më 2024 dhe tash.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, tha se vazhdojnë mbështetjen e të rinjve dhe grave në biznes. “Me një fond prej 500 000 eurove për një mandat,

tashmë kemi ndihmuar 73 ndërmarrës të rinj dhe po vëmë në dispozicion 150 000 euro shtesë për vitin 2025”, tha kryetari Alban Hyseni.

Ai i inkurajoi të rinjtë dhe gratë të aplikojnë tani dhe ta bëjnë realitet idenë e tyre të biznesit.



KOMF-i LETËR PARTIVE POLITIKE PËR KRIJIMIN E MINISTRISË PËR MIRËQENIE SOCIALE

PRISHTINË, 7 PRILL - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF) përmes kësaj letrë u drejtohet subjekteve politike që do të krijojnë qeverinë, me kërkesën që të rikthehet Ministria për Mirëqenie Sociale.

KOMF-i konsideron se mirëqenia dhe shërbimet sociale duhet të jenë prioritet dhe një ndër shtyllat kryesore të programit të qeverisë për shkak të rëndësisë dhe nevojës për ndërhyrje në këtë fushë. “Prandaj kjo duhet të reflektohet edhe në ndarjen e ministrive, specifiku në krijimin e Ministrisë që do të ketë në portofolio politikat dhe mirëqenien sociale, shërbimet sociale, mbrojtjen e fëmijëve, fuqizimin e familjeve, etj. Mirëqenia sociale mbetet ndër sektorët më në nevojë për ndërhyrje dhe investime. Të dhënat e fundit nga Karta e Vlerësimit të publikuar nga KOMF në vitin 2024, tregojnë se shteti i Kosovës nuk ka prioritetizuar dhe nuk ka politika dhe programe të mjaftueshme për mbrojtjen e fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve. Në anën tjetër, kërkesat për shërbime nga qytetarët në nevojë janë në rritje të madhe viteve të fundit”, ka njoftuar KOMF-i.

KOMF-i kërkon prioritetizimin e mirëqenies sociale, fuqizimin e familjes dhe mbrojtjen e fëmijëve, përmes krijimit të ministrisë së veçantë për këto fusha shumë të rëndësishme. “KOMF kërkon që në kuadër të

kësaj ministrie, të rikthehen si sektori i politikave dhe skemave sociale, ashtu edhe ai i shërbimeve sociale. Në të gjitha praktikën, në emër të interesit më të mirë të qytetarëve në nevojë për shërbime dhe mbrojtje, skemat sociale shërbejnë si një instrument apo masë, e cila është një ndër format e shërbimeve sociale, dhe e cila krahas formave të tjera të këtyre shërbimeve, synon fuqizimin e individit dhe familjes”, ka theksuar KOMF-i. Sipas KOMF-it, të dhënat nga institucionet publike, agjencitë ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare tregojnë për probleme të mëdha në këtë fushë. “Dhuna dhe ndëshkimi i fëmijëve në Kosovë vazhdon të praktikohet në masë të madhe. 72% e fëmijëve në Kosovë disiplinohen përmes formave të dhunshme. Kosova vazhdon të mos ketë shërbime të specializuara të ofruara për të adresuar mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda, përfshirë fëmijët në situatë rruge. 5% e fëmijëve në Kosovë punojnë punë të rënda. Vetëm 10% e fëmijëve më aftësi të kufizuara përfitojnë nga shërbimet shëndetësore dhe sociale cilësore. Fëmijët pa përkujdesje prindërore vazhdojnë të mbesin pa shtesa të fëmijëve dhe pa përkrahjen financiare që qeveria ka ndarë për fëmijët, gjatë viteve të fundit”, ka njoftuar KOMF-i, duke theksuar se Kosova përballet me sfida të



shumta në parandalimin dhe trajtimin e fëmijëve viktime të abuzimit me narkotikë. “Viteve të fundit, vlerësohet se numri i përgjithshëm i përdoruesve ka kaluar për herë të parë shifrën prej 30.000 ndërkohë që fëmijët dhe adoleshentët përdorues vazhdojnë të bëjnë pjesë çdo vit e më shumë në këtë shifër. Mosha mesatare e fillimit të përdorimit të drogave ka rënë nga 18 vjeç në vitin 2018, në 16

vjeç në periudhën e fundit. Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin është në rritje. Gjatë 2023, numri i fëmijëve në konflikt me ligjin, raportuar nga Policia e Kosovës, ka qenë 2.175 fëmijë, ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur të pranuar gjatë 2023, është rritur për 18.00 %, krahasuar me 2022. Shteti është përgjegjës për mirëqenien sociale, organizimin e ofrimit të

shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe për të siguruar që të gjithë banorët e Republikës së Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbime sociale dhe familjare pa asnjë dallim. Shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut”, ka njoftuar KOMF-i.

KËSHILLI I SIGURISË: SERBIA PO TENTON TA SABOTOJË KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA TË KOSOVËS



PRISHTINË, 7 PRILL - Këshilli i Sigurisë i Kosovës e ka akuzuar Serbinë se po tenton ta “sabotojë themelimin e institucioneve të reja” dhe legjislaturës së nëntë të Kosovës të dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Qeveria e Kosovës njoftoi se Këshilli i Sigurisë së Kosovës mbajti mbledhje më 6 prill me kërkesë të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, për të diskutuar për gjendjen e sigurisë, por edhe për, siç u tha, planet destabilizuese të Serbisë. Në njoftim u përsëritën akuzat e mëhershme të bëra nga Qeveria e Kosovës se Serbia ka ndërhyrë në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit përmes Listës Serbe - akuza që janë bërë edhe nga Gjermania dhe misioni i

Bashkimit Evropian për monitorimin e zgjedhjeve. “Serbia tash po ndërhyr te disa prej deputetëve të komuniteteve joshumicë e joserbë, që ta sabotojë themelimin e institucioneve të reja të legjislaturës së nëntë. Me kërcënime e joshje, dhe sidomos me shantazhe, ajo po orvatet të nxisë tensione ndëretnike e ndërpartiake në Kosovë dhe ta destabilizojë Kosovën”, u tha në njoftimin e lëshuar nga Zyra e Kurtit, pa përmendur se për cilët deputetë bëhet fjalë dhe nga cilat komunitete janë. Këshilli i Sigurisë tha se kjo paraqet ndërhyrje ndaj “sovrانيتit shtetëror, funksionimit demokratik dhe integritetit institucional të vendit tonë”.

Në Aeroportin e Prishtinës kapet një person me 144 boksa të cigareve

PRISHTINË, 7 PRILL - Dogana e Kosovës ka njoftuar se më 6 prill rreth orës 10:30 në dalje të Aeroportit të Prishtinës, gjatë kontrollit doganor, është ndaluar një udhëtar me

fluturimin Prishtinë - Londër, shtetas shqiptar. Gjatë kontrollit të bagazheve të tij, të realizuar përmes skanimit dhe në prani të tij, është zbuluar mall i

padeklaruar, konkretisht sasi e konsiderueshme e cigareve me banderola të Shqipërisë dhe RKS-së. “Totali: 28 800 copë cigare (144 boksa). Malli është ndaluar sipas

procedurave si dhe rasti është duke u trajtuar si kundërvajtje doganore, derisa mallrat janë konfiskuar”, ka njoftuar Dogana.



Paradoksi i tregut të patundshmërive: Mbi 180 mijë banesa të zbrazëta

Kosova po ndërtohet me ritme të shpejta, por pas këtij bumi fshihet edhe një paradoks: mijëra banesa mbeten bosh. Investimet nga diaspora e kanë gjallëruar tregun por, mesa duket, pa ndikim real në ekonomi



PRISHTINË, 7 PRILL - Për 13 vjet - nga 2011-ta deri më 2024 - numri i banesave dhe shtëpive në Kosovë është rritur për 43 për qind. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se vendi, me rreth 1.6 milion banorë, ka 590 mijë banesa apo shtëpi të banueshme. Kjo do të thotë se, mesatarisht, çdo i treti banor ka “kulm mbi kokë”. Të dhënat e dala nga regjistrimi i popullsisë vitin e kaluar tregojnë se mbi 96 për qind e familjeve janë pronare të shtëpive ku jetojnë. Vëzhguesit e këtij trendi thonë se mentaliteti i qytetarëve është që investimi në objekte banimi siguron zgjidhje afatgjatë për mirëqenien e familjes. “Kohën e fundit çiftet e reja e sigurojnë banesën e tyre edhe më herët dhe numri i anëtarëve në familje është më i vogël se në të kaluarën”, thotë Naser Kabashi, profesor në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës për “Radion Evropa e Lirë”. Por, një shifër që ai e konsideron shqetësuese, është ajo e banesave të zbrazëta. Sipas ASK-së, në Kosovë janë mbi 182 mijë të tilla, që përfshijnë banesat ende në ndërtim, të blera dhe të destinuara për shitje. Përfaqësues të agjencive të patundshmërive dhe pronarë të kompanive ndërtuese thonë se një përqindje e madhe e banesave të pabanuara janë pronë e diasporës. Këto pohime mbështeten edhe

nga të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës, sipas të cilave, diaspora zë vendin e parë sa iu përket investimeve të huaja që bëhen kryesisht në patundshmëri. Nga mbi 856 milionë euro investime të huaja vitin e kaluar, mbi 647 milionë u investuan në sektorin e patundshmërisë. Për Kabashin, banesat e blera kryesisht nga diaspora, janë “një pasuri e vdekur e pashfrytëzuar”, e cila nuk sjell asnjë rezultat në zhvillimin ekonomik. Me të pajtohet edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, i cili thotë se investimet e tilla e ndihmojnë sektorin e ndërtimit, por shton se, kur këto prona mbeten të pashfrytëzuara për pjesën më të madhe të vitit, ato nuk japin ndonjë kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik. “Është mirë që diaspora ka blerë shtëpi e banesa, por si investim nuk është i orientuar siç duhet”, thotë Rafuna për “Radion Evropa e Lirë”. Ai shton se, sikur këto mjete të investoheshin në industrinë e prodhimit, përfitues do të ishin edhe vetë blerësit, por edhe qytetarët e tjerë të vendit. “Nëse do të rritej prodhimi, mërgimtarët do të përfitonin nga dividendi [v.j. shpërndarja e fitimeve nga një korporatë për aksionarët e saj]”, thotë Rafuna. “Kosova pastaj do t’i zgjeronte kapacitetet prodhuese, do ta rriste eksportin dhe do ta ulte

importin. Në këtë mënyrë do të përmirësohej mirëqenia sociale dhe do të ulej shkalla e papunësisë”, shpjegon kryetari i OEK-ut. Shkalla e papunësisë në Kosovë është mbi 10 për qind, kurse në mesin e të rinjve nga 15 deri në 24 vjeç është gati 20 për qind. Kosova mbetet skajshmërisht e varur nga importi i mallrave, por edhe nga remitencat, vlera e të cilave arrin në mbi 1 miliard euro në vit.

Sa kushtojnë banesat?

Çmimet e banesave në Kosovë filluan të rriten në vitin 2021 si pasojë e çrregullimeve në tregjet ndërkombëtare që i shkaktoi pandemia Covid-19. Ky trend vazhdoi edhe gjatë vitit 2022 pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Me rritjen e çmimeve të materialeve ndërtimore, banesat u shtrenjtuan mbi 20 për qind. Burim Halili, pronar i një agjencie të patundshmërisë në Prishtinë, tregon se çmimi i një

metri katror të banesave në Prishtinë aktualisht sillet nga 1 000 deri në 2 500 euro - varësisht nga lagja dhe kompania ndërtuese. Në komunat më të vogla, ndërkaq, arrin deri në 800 euro. “Fatkeqësisht, nuk kemi ulje të çmimeve. Përkundrazi, kemi ngritje çdo ditë”, thotë Halili. “Radio Evropa e Lirë” ka sjellë disa herë rrëfime të qytetarëve që nuk mund ta përballojnë blerjen e një banese në komunën ku jetojnë. Brahim Selimaj nga Shoqata e Ndërtueseve të Kosovës pret që çmimet të nisin të bien meqë, siç thotë, edhe ndërtimet janë në rënie e sipër. “Po shkohet në atë drejtim që çmimi të jetë sa më i vogël për shitje, për shkak të mungesës së kërkesës. Kërkesa për blerje është në rënie dhe ndërtuesi nuk ka zgjidhje tjetër pos ta zbrësë çmimin”, thotë Selimaj, i cili është edhe pronar i një kompanie ndërtimore. Të dhënat e ASK-së tregojnë, po ashtu, për më pak shitje të

banesave. Sipas Indeksit të Çmimeve të Pronës Banesore, në gjashtë muajt e parë të vitit 2023 janë shitur vetëm 1 628 banesa në të gjithë Kosovën. Ky numër ishte dukshëm më i ulët krahasuar me 4 967 sa ishin shitur gjatë gjithë vitit 2022 dhe 6 561 në vitin 2021. Komuna e goditur më së keqi ishte ajo e Gjilanit me mbi 90 mijë banorë, ku në gjashtë muajt e parë të vitit 2023 ishin shitur vetëm gjashtë banesa. Për gjysmën e dytë të vitit 2023 dhe për vitin 2024, ASK-ja nuk dha shifra për numrin e banesave të shitura, pavarësisht interesimit të “Radios Evropa e Lirë”. Në Kosovë paga mesatare është rreth 570 euro në muaj. Të dhënat e ASK-së tregojnë se pjesa më e madhe e buxhetit familjar në vend ndahet për blerjen e artikujve ushqimorë. Madje pjesa më e madhe e ekonomive familjare e kanë problem të përballojnë ndonjë shpenzim të papritur mbi 200 euro.

ZRRE-ja paralajmëron se tarifat e reja të rrymës pritet të hyjnë në fuqi më 1 maj

PRISHTINË, 7 PRILL - Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës (ZRRE) ka thënë të hënën se tarifat e reja të rrymës pritet të hyjnë në fuqi nga 1 maji, në pritje të marrjes së vendimit për shtrenjtimin e rrymës për 15 për qind. “Vendimi për rritje do të merret nga mesi i këtij muaji, ndërsa tarifat e reja do të nisin të aplikohen nga data 1 maj e këtij viti”, tha Petrit Pepaj nga ZRRE-ja gjatë një takimi me gazetarë. Rregullatori i energjisë propozoi muajin e kaluar shtrenjtimin e çmimit të energjisë elektrike në vend për rreth 15 për qind, duke nxitur reagime dhe protesta. Bordi i ZRRE-së pritet të marrë vendim për çmimin e rrymës më 11 prill. Shtrenjtimi i rrymës u kundërshtua nga Presidenca dhe nga qytetarë që protestuan të shtunën në kryeqytet. ZRRE-ja bën shqyrtimin dhe caktimin e përvitshëm të tarifave të rrymës, të cilat

shpallen çdo 1 prill dhe vlejnë deri më 31 mars të vitit pasues. Javë më parë tri kompanitë e sektorit të energjisë në Kosovë i kërkuan rregullatorit të energjisë rritjen e çmimit të tarifave të rrymës. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut [KOST], Kompania për Distributim të Energjisë Elektrike në Kosovë [KEDS] dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike [KESCO] kërkuan ngritjen e çmimit të tarifave të rrymës për shkak të importit të energjisë elektrike. ZRRE-ja ka argumentuar se rritja e tarifave këtë vit është e domosdoshme, për shkak të uljes së prodhimit të energjisë, rritjes së konsumit dhe varësisë së madhe nga importet me çmime të larta. Kosova nuk mund ta sigurojë energjinë e nevojshme për mbi 1.6 milion banorët e saj vetëm



me prodhimin nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). Një nga arsytet është vjetërsia me dekada e termocentraleve “Kosova A” dhe “Kosova B”. Prodhim ka edhe përmes burimeve të ripërtërishme, por në sasi më të vogla. Përfaqësuesit e bizneseve kanë thënë më herët se rritja

eventuale e çmimit të rrymës do t’i rriste kostot operative të bizneseve. Kjo më pas do t’i detyronte bizneset që ta rrisnin çmimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre, duke i bërë ato më pak konkurruese në treg. Kosova vitet e fundit është përballur me rritje të vazhdueshme të çmimeve të

produkteve dhe shërbimeve. Shtrenjtimi ka nisur në kohën e pandemisë Covid-19 në vitin 2020 dhe ka marrë hov pasi Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 2022. Vitin e kaluar ZRRE-ja e uli çmimin për konsumatorët komercialë dhe industrialë për 3 për qind. Por, një vit më herët, më 2023, tarifat u rritën për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Aktualisht, për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi i rrymës gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh. Nga ora 22:00 deri në 7:00 të mëngjesit, çmimi për kilovat është 3.34 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë dhe 6.81 centë për ata që shpenzojnë më shumë.

MACRON NË MISION PAQEJE NË LINDJEN E MESME



Presidenti francez, Emmanuel Macron po angazhohet për armëpushim në luftën e Gazës. Të hënën (07.04.), presidenti francez takohet me presidentin egjiptian Abdel Fattah al-Sisi dhe mbretin jordanez Abdullah II, njoftoi vetë Macron në shërbimin online X. Presidenti francez mbërriti të dielën në mbrëmje për vizitë në Kajro. Kurse të martën Macron dëshiron të udhëtojë pranë Rripit të Gazës. Sipas Pallatit Elysée, ai planifikon një takim me punonjësit humanitarëpol në qytetin Al-Arish për të nënvizuar mbështetjen e tij për një armëpushim midis Izraelit dhe Hamasit. Arish ndodhet rreth 50 kilometra nga Rripi i Gazës dhe është një pikë e rëndësishme kalimi për dërgimin e ndihmave në territorin palestinez

Fokusi tek Gaza

Është takimi i dymbëdhjetë mes Macron dhe al-Sisit, që kur Macron mori detyrën në vitin 2017. Por ky udhëtim konsiderohet veçanërisht i rëndësishëm. "Do të flitet për krizat në rajon - në Siri dhe vendet fqinje të Libisë, Sudanit dhe Izraelit," tha Pallati Elysée. Ka shpresë për një përparim në konfliktin e Lindjes së Mesme - gjithashtu duke pasur parasysh rolin e Francës si një urë lidhëse me botën arabe. Zyrtarisht flitet se tema qendrore është bashkëpunimi ekonomik. Por fokusi i vërtetë është tek lufta e Gazës. Izraeli

së fundi e theu armëpushimin që e arriti si vend në janar me Hamasin, që është klasifikuar si organizatë terroriste nga SHBA, BE, Gjermania dhe disa shtete arabe. Izraeli filloi ofensivë të gjerë në Rripin e Gazës pasi Hamasi sulmoi Izraelin më 7 tetor 2023, dhe vrau më shumë se 1200 njerëz, mori më shumë se 200 pengje, nga të cilët jo të gjithë janë ende të lirë. Sipas Hamasit, më shumë se 50,000 njerëz thuhet se kanë vdekur në sulmet izraelite në Rripin e Gazës. "Ne do të flasim për një armëpushim dhe një fund të mundshëm të luftës," thotë një zëdhënëse e Elysee. "Ne duam gjithashtu të vulosim një partneritet strategjik midis Francës dhe Egjiptit - si ai që ekziston tashmë për Egjiptin dhe BE-në."

Rruga e De Golit në botën arabe

Franca ka një pozicion kyç ndër shtetet e BE-së në Egjipt - dhe në botën arabe - shpjegon Ahmed El Keiy, ish-gazetar, drejtor menaxhues i qendrës së konsulencës politike AEK Conseil. Marrëdhëniet franko-egjiptiane kanë qenë të shkëlqyera për dekada të tëra, tha ai në një intervistë për DW. "Shumë kompani franceze operojnë në Egjipt dhe kanë dhjetëra mijëra punonjës atje. Egjipti ishte gjithashtu vendi i parë që bleu 24 avionë luftarakë Rafale në 2015, duke hapur rrugën për eksporte të

mëtejshme të avionëve në vende të tjera." Egjipti është një nga importuesit kryesorë të mallrave ushtarake franceze. Këto marrëdhënie të ngushta historikisht lidhen me politikën e Lindjes së Mesme të ish-presidentit të shtetit të Francës, Charles de Gaulle. Ish gjenerali, i cili drejtoi Francën nga viti 1958 deri në 1969, zgjodhi një rrugë të mesme për Lindjen e Mesme: mbështetjen dhe njohjen e shtetit të Izraelit, por jo pa kushte. De Gaulle e dënoi Izraelin pasi vendi filloi Luftën Gjashtë Ditore me një sulm parandalues në Egjipt në qershor 1967 dhe vendosi një embargo armësh. Ai bëri thirrje për maturi në marrëdhëniet e tij me shtetet arabe.

"Kjo është një arsye tjetër pse Franca njihet shumë mirë në botën arabe dhe veçanërisht në Egjipt," shpjegon El Keiy. Gazetari Khaled Saad Zaghloul, i cili është akredituar në Elysee që nga viti 1995, e përjeton këtë drejtpërdrejt. "Presidentët Jacques Chirac, Nicolas Sarkozy, François Hollande dhe tani Emmanuel Macron janë koordinuar të gjithë me Kajron të paktën çdo javë", shprehet gazetari egjiptian për DW. "Që nga traktati i paqes midis Egjiptit dhe Izraelit i nënshkruar në vitin 1979, Kajro ka qenë e pranuar." Në atë kohë, Egjipti ishte vendi i parë arab që njohu zyrtarisht Izraelin si pjesë e së ashtuquajturës Marrëveshje e Camp David. Për Fawaz Gerges, profesor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në London School of

Economics, udhëtimi i Macron zhvillohet në rrethana të veçanta. "Macron po përdor vakumin ndërkombëtar të pushtetit për t'u paraqitur si lider i botës perëndimore - në fund të fundit, SHBA-ja tani shihet si e pabesueshme. Gjermania është ende në negociata koalicioni. Po ashtu ky vend ka më pak prani në Lindjen e Mesme, ashtu si Italia dhe Britania e Madhe", tha Gerges në një intervistë për DW. Dhe Egjipti është një pikë kyçe, sipas ekspertit. Me rreth 110 milionë banorë, ai shtrihet në udhëkryqin e Afrikës, Azisë dhe Evropës. "Ajo që po ndodh në Egjipt ka efekte të gjera," thotë Gerges. "Vendi është i rëndësishëm kur bëhet fjalë për emigracionin. Ai pranon shumë refugjatë nga vendet fqinje dhe, ndryshe nga Libia, ata nuk ecin më tej. Konsiderohet një strehë e stabilitetit në një rajon ku ka luftëra civile dhe grupe terroriste janë aktive."

Rritje e presionit për t'i dhënë fund luftës

Në kryeqytetin egjiptian në fillim të marsit, 22 shtetet anëtare të Ligës Arabe ranë dakord për një plan për të rindërtuar Rripin e Gazës në pesë deri në shtatë vjet. Banorët nuk duhet të largohen nga rajoni bregdetar në Mesdhe. Synimi është administrimi nga Autoriteti Palestinez i Bregut Perëndimor. Propozimi bie ndesh me planin e presidentit amerikan Donald Trump për të

zhvendosur palestinezët në Egjipt dhe Jordani për të rindërtuar Rripin e Gazës. "Plani arab është një bazë e mirë për diskutime, por duhet të plotësohet në lidhje me garancitë e sigurisë dhe formën e ardhshme të qeverisjes në Gaza", tha një zëdhënëse e Elysee, duke shtuar se rezultatet e vizitës do t'i paraqiten edhe Uashingtonit më vonë. Franca dhe Arabia Saudite po planifikojnë gjithashtu një konferencë mbi zgjidhjen me dy shtete këtë qershor. Saad Zaghloul shpreson që udhëtimi i Macron të japë fryte. "Franca, BE dhe Egjipti duhet të rrisin presionin për t'i dhënë fund përfundimisht luftës," thotë ai. Amnesty International, megjithatë, po bën thirrje që Franca të përdorë marrëdhëniet e saj me Egjiptin edhe për të përmirësuar gjendjen e të drejtave të njeriut. Organizata ndërkombëtare joqeveritare flet për një "krizë të të drejtave të njeriut" dhe "represion sistematik të politikanëve dhe gazetarëve opozitarë" atje. "Macron duhet të thekosjë në mënyrë eksplicite të drejtat e njeriut në deklaratën përfundimtare, të kërkojë lirinë e të burgosurve politikë dhe që zgjedhjet parlamentare të këtij gushti të zhvillohen të lira dhe demokratike", tha përfaqësuesja e Amnesty International në Egjipt, Lena Collette, në një intervistë për DW.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova nis përgatitjet për ndeshjen ndaj Suedisë

PRISHTINË, 7 MARS - Nën drejtimin e selektorit Agron Shabani, Kosova në hendboll (vajzat) ka nisur përgatitjet për dy ndeshjet me Suedinë. Ndeshjet me Suedinë i takojnë fazës së fundit kualifikuese për Kampionat Botëror. Suedia është kundërshtarja më e fortë

e mundshme në raundin e dytë kualifikues. Ka shumë lojtare në nivelin më të lartë evropian dhe suksese të shumta. Kosova është grumbulluar në Eslov të Suedisë, ndërsa stërvitja e parë u zhvillua të hënën paradite. Në Përfaqësuesen e Kosovës ka

atmosferë punë, ndërsa shtabi teknik dhe hendbollistet janë të vetëdijshme për sfidat që i presin dhe nivelin e kundërshtarëve. Ndeshja e parë është të enjten prej orës 19:00 në Suedi, ndërsa e kthimit të dielën nga ora 17:15 në Prishtinë.



Neziri: Dukagjini ka merituar më shumë pikë



“Epoka e re”

KLINË, 7 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i Javës”. Ky çmim për javën e 27 në Albi Mall Superligë i është ndarë futbollistit të KF Dukagjini, Faton Neziri. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Shyqeri Salihu, Bujar Asllani dhe Fatmir Mehmeti. Ky komision vendosi që çmimi “Ylli i javës” për xhiron e njëzet e shtatë t’i takojë Faton Nezirit, i cili shënoi dy golat në fitoren 3:1 të Dukagjinit në ndeshjen e rëndësishme kundër KF Llapit. Pasi mori këtë çmim, Neziri u

shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: “Ndeshjen e kemi përgatitur gjatë gjithë javës, kemi pasur stërvitje shumë të mirë dhe ia arritëm qëllimit për të marrë tri pikë të plota. Atmosfera te KF Dukagjini është shumë e mirë dhe çdo ndeshje e luajmë pa presion. Nga performanca jonë kemi merituar më shumë pikë dhe të jemi më mirë në renditjen tabelore”. “Megjithatë, ka edhe shumë ndeshje dhe besoj se do të pozicionohemi më mirë. Është ndjenjë shumë e mirë të shpallesh ‘Ylli i javës’, andaj jam shumë i lumtur dhe e shfrytëzoj rastin të falënderoj bashkëlojtarët, trajnerin dhe udhëheqësinë e klubit për besimin”, ka deklaruar Neziri për faqen zyrtare të FFK-së.

Përfundon edicioni i rregullt, Bashkimi renditet i pari

PRIZREN, 7 MARS - Në fundjavë përfundoi edicioni i rregullt i ProCredit Superligës, që dhuroi mjaft ndeshje interesante, atmosferë të zjarrtë në tribuna dhe sfida të bukura në parket. 28 xhiro, ku takimet e fundit kanë qenë vendimtare për renditjen përfundimtare para garave shtesë apo “play-off”-it, që pritet të jetë i zjarrtë. Bashkimi përfundoi garat në vendin e parë me 20 fitore e tetë humbje, ndërsa kampionia

Trepça e dyta me 19 fitore e nëntë humbje. Këto dy skuadra u kualifikuan në gjysmëfinale. Në çerekfinale do të përballen Sigal Prishtina me Vëllaznimin, apo finalistët e Ligës Unike. Bardhekaltrit u renditën të tretit me 17 fitore e 11 humbje, ndërsa kuqezinjtë në pozitën e gjashtë me 13 fitore e 15 humbje. Sfida tjetër çerekfinale do të jetë ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Pejës. Therandasit janë në formë të

lartë me gjashtë fitore radhazi në elitë, ku u renditën në vendin e katërt me 15 fitore e 13 humbje, ndërsa pejanët në pozitën e pestë me 14 fitore e 14 humbje. Bora në edicionin debutues kishte nëntë fitore e 19 humbje, duke u renditur e shtata dhe do të garojë në “play-out” me finalistin e Ligës së Parë të meshkujve. Proton Cable Prizreni është i teti me pesë fitore e 23 humbje, duke rënë nga Superliga.



Pesëshja dhe MVP i xhiros së fundit në Superligë

PRISHTINË, 7 MARS - Përfunduan 28 xhirot e rregullta në ProCredit Superligën e Kosovës në basketboll, duke u qartësuar gjithçka për garat shtesë. Në javën e fundit u zhvilluan disa përballje mjaft interesante. Golden Eagle Ylli vazhdoi me formë të lartë për

ta regjistruar fitoren e gjashtë radhazi, kësaj radhe duke mundur Proton Cable Prizrenin. Lis Shoshi zhvilloi ndeshje të jashtëzakonshme, duke pasur 25 pikë, 15 kërcime e katër asistime, me indeks 40, apo më të lartin e kësaj xhiro. Ai shpallet MVP i javës së 28. Bashkimi fitoi

derbin ndaj Pejës, ku te portokallezinjtë u dallua Lejson Zeqiri me 22 pikë, gjashtë kërcime e katër asistime, duke u ndihmuar nga Dirk Williams, i cili mbylli ndeshjen me dhjetë pikë, 13 kërcime e gjashtë asistime. Trepça fitoi ndaj Borës, ku Tekele Cotton po

vazhdon me formë të mirë, ku ndaj prishtinasve kishte 13 pikë, pesë kërcime e 11 asistime. Sigal Prishtina mbylli garat e rregullta me fitore në Gjakovë ndaj Vëllaznimit, ku te bardhekaltrit u dallua Rashid Mahalbasiq me dhjetë pikë, 12 kërcime dhe dy asistime.



Verstappeni: Po të pilotoja një McLaren ata s'do të më shihnin as targën

HASSELT, 7 MARS - Max Verstappeni triumfoi ditën e diel në garën e zhvilluar në Japoni, një sukses i madh për pilotin holandez të Red Bullit. Ai tregoi mjeshtri në pistë me pilotimin e tij dhe menaxhimin e gomave, duke ditur të mbajë pas dy makinat McLaren, që kanë konfirmuar

deri më tani se janë më të shpejtat. Këtë fakt e vë në dukje vetë Verstappeni, që nuk i intereson modestia kur thotë: “As nuk dua të mendoj se çfarë do të kishte ndodhur në pistë nëse do të isha unë duke pilotuar një McLaren. Në atë rast, rivalët nuk do të më kishin parë fare”. Një kampion

që e di se ka bërë diçka të veçantë në një pistë që nuk lejon gabime, sidomos pas një xhiro të përsosur të shtunën i dha atij “pole position”. “Bëmë një garë të mirë dhe kjo fitore ka shumë rëndësi për ne. Nuk ishte e lehtë, por skuadra bëri një punë të mirë”, ka deklaruar Verstappenin.

Tashmë holandezi është një pikë pas Lando Norris në renditjen e përgjithshme për pilotë në Formula 1. Verstappenin po mban i vetëm në lojë makinën Red Bull, që ende nuk është në nivelin e McLarenit, duke konfirmuar kandidaturën e tij për titullin e pestë kampion bote radhazi.



Bolt: Tani jam kampion në domino dhe prodhoj muzikë, ja trofeu i parë që kam marrë

SHERWOOD CONTENT, 7 MARS - “Unë jam njeriu më i shpejtë në botë, por tani jam në pension. Nuk do të doja të bëja asgjë, por gjithmonë ka diçka për të bërë”. Kështu u shpreh Usain Bolt, rekordmeni botëror në 100 dhe 200 metra. Ish-sprinter i xhamajkan ka fituar 11 medalje ari në Kampionatin Botëror dhe 8 medalje ari në Olimpiadë. Ai shprehet se edhe pse ka arritur gjithë këto rezultate e mban këto rekorde, ai mund të kishte arritur më shumë. “Kam fituar shumë, por mund të kisha bërë edhe më mirë për të ecur më shpejt. Asnjëherë nuk u shqetësova për rekordet. Më pëlqente të fitoja, të garoja dhe, gjithashtu, të argëtohesha”, shprehet Bolt. Më tej, ai rrëfen: “Mbay mend fitoren time të parë. Isha rreth 7 vjeç, por ishte dikush që ishte më i shpejtë se unë. Trajneri më tha ‘nëse e mund do të jap një kuti për ta futur drekën’ dhe unë fitova. Kujtimet nuk mund të fshihen”. “Rritja në fshat ishte një gjë e mrekullueshme që më bëri të bëhesha personi që jam



sot. Gjithmonë mallëngjehem kur kujtoj kohën e kaluar. Të dish që arrita të bëja kaq shumë njerëz të lumtur është një ndjenjë e mrekullueshme”, ka pohuar xhamajkani. “Tani luaj domino, nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 18:00. Luaj me miqtë. Po mundohemi të bëjmë diçka ndryshe. Bëjmë turne domino në Xhamajka, por unë jam kampion midis miqve të mi. Dhe unë jam producent muzikor. Nuk këndoj, por prodhoj muzikë dhe kushedi, ndoshta një ditë do

të fitoj një Grammy”, ka deklaruar Bolt. Lojërat Olimpike të Londrës ishin momenti më i lartë i karrierës së tij: “Kishte një mbështetje të çmendur, kaq shumë xhamajkanë. Nuk kam parë kurrë një stadium kaq të mbushur nga mëngjesi në mbrëmje”. Sot Bolt është 38 vjeç dhe ka tre fëmijë, por nuk e ëndërron një të ardhme për ta në atletikë. “Nëse vendosin të vrapojnë duhet të bëjnë atë që bëri babi. Djemtë nuk janë të shpejtë, vajzat janë”.

Lakersat fitojnë duelin e kreut me Oklahoman, triumfojnë Bostoni, Milwaukee dhe Houstoni

OKLAHOMA, 7 MARS - Humbja e dytë radhazi për kryesuesit e Oklahomas, që u mundën në

REZULTATET	
Charlotte - Chicago	117-131
Oklahoma - Lakers	99-126
Brooklyn - Toronto	109-120
Atlanta - Utah Jazz	137-134
Boston - Washington	124-90
Cleveland - Sacramento	113-120
Portland - San Antonio	120-109
New York - Phoenix	112-98
Denver - Indiana	120-125
Golden State - Houston	96-106
New Orleans - Milwaukee	107-111

fushën e vet nga lakersat, një përballje mes dy ekipesh rivale për titull. Luka Doniqi me 30 pikë ishte lider për lakersat, ndërsa 26 pikët e Shait për Oklahoman mbetën për statistikë. Edhe ekipi i Clevelandit, që kryeson në Lindje, u mund me rezultat 120-113 nga Sacramento, takim ku Zach LaVine realizoi 37 pikë. Kampionët në fuqi të Bostonit fituan me rezultat 124-90 ndaj Washingtonit, ndeshje ku shtatë lojtarë të Celtsit realizuan mbi 10 pikë. Zhgënjeu skuadra e Golden



States, që në fushën e vet u mund me rezultat 106-96 nga Houstoni (Dillon Brooks 24 pikë), ndërsa Milwaukee fitoi me rezultat 111-07 në fushën e New Orleansit. Trenti me 29 pikë ishte shënuesi më i mirë për Bucksin.

Arteta: Ta godasim Realin te pikat e dobëta

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, në konferencën e sotme për shtyp para takimit ndaj Real Madridit në Ligën e Kampionëve, iu përgjigj

pyetjeve të gazetarëve. “Realit është një klub shumë i madh me shumë histori, por ne duhet ta krijojmë tonën. Duhet të fokusohemi në këtë takim për

ta dhënë maksimumin dhe t'i shfrytëzojmë pikat e dobëta të rivalëve, sepse kanë të tilla. Carelo është frymëzim. Ai është tekniku me historinë më të mirë

nga të gjithë të tjerët. Ai ka fituar në shumë vende ku ka punuar. Të gjithë ata që kanë punuar më atë thonë se transmeton qetësim”, ka deklaruar Arteta.

“Të tilla mbrëmje na mungonin prej shumë kohësh në Londër dhe tani që kemi shansin të luajmë, do të tregojmë se jemi gati”, ka shtuar Arteta.

SHKURT

Aliti mori pjesë në takimin koordinues për LM ‘Taranto 2026’

Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti, mori pjesë në takimin koordinues për Lojërat Mesdhetare “Taranto 2026”. Komisioni bashkë edhe me sekretarin e përgjithshëm të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), Iakovos Filippousis, mbajtën takim të frytshëm me Komitetin Organizativ, me të cilët diskutuan për progresin e përgatitjeve të organizimit të LM Taranto 2026. Edicioni i 20 i LM Taranto 2026 mbahet prej 21 gushtit deri më 3 shtator 2026 në qytetin Taranto të Italisë. Kujtojmë që pas Tarantos, mikpritëse e Lojërave të ardhshme Mesdhetare është “Prishtina 2030”.

Shaqiri: E merituar fitoren ndaj Luganos

Lojtari me origjinë shqiptare, Xherdan Shaqiri, realizoi një gol në fitoren 2-0 të Baselit ndaj Luganos në kampionatin zviceran. “Janë ndeshje që kundër top-ekipeve duhet t'i fitosh. Kjo xhiro shkoi mirë për ne. Sigurisht që ne duhej të fitonim dhe e bëmë këtë. Është një fundjavë shumë e bukur. Ne donim t'ia impononim lojën tonë Luganos. E bëmë këtë në pjesën e dytë dhe merituar fitoren. E dinim që Lugano do të jepte gjithçka sot, por në fund ishim ekip më i mirë”, ka thënë kapiteni i Baselit.

Guradiola pas barazimit ndaj Unitedit: Duhet të shohim vetëm përpara

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka thënë pas barazimit ndaj Manchester Unitedit (0-0), se e kanë dëshiruar fitoren, por edhe përkundër faktit se ajo nuk është arritur duhet të shohin vetëm përpara. “Sigurisht që dëshironim fitoren, por ‘Old Trafford’ është ‘Old Trafford’. Që të fitosh këtu duhet të zhvillosh një performancë shumë të mirë. Gjithsesi po shoh përmirësim ndeshje pas ndeshje. Marrim këtë pikë e shohim vetëm përpara nga e ardhmja”, ka thënë Guardiola.

Van Dijk nuk e rinovon kontratën me Liverpoolin, pritët t'i bashkohet PSG-së

Mbrojtësi Virgil van Dijk nuk ka pranuar për herë të dytë mundësinë për ta rinovuar kontratën me Liverpoolin. Mbrojtësi holandez do të largohet në fund të këtij sezoni si lojtar i lirë. Edhe pse 33-vjeçar, ai mbetet një nga qendërmbrojtësit më të mirë në botë, jo më kot ka dhe një interes shumë të madh për të nga disa klube të njohura. Por, mesa duket Van Dijk e ka zgjedhur destinacionin e ri dhe është Parisi. Qendërmbrojtësi holandez pëlqehet shumë nga Luis Enrique. Spanjollit iu ka kërkuar drejtuesve të klubit t'i nisin sa më parë bisedimet me të. Klubi francez është i gatshëm të ofrojë një kontratë dyvjeçare me mundësi rinovimi për një vit plus një rrogë të kënaqshme.

Drejtoria e Shmlm „Luciano Motroni,, në Prizren

Nr. i prot: 276 Dt: 07.04.2025

Mbështetur ne nenin 11, të Udhëzimit Administrativ-Aktivitetet jashtëkurrikulare Nr.02/2016 dhe në vendimin nr.prot:122 te datës: 13.02.2025, te KDSH-së Shmlm „Luciano Motroni,, në Prizren, rishpall:

R I S H P A L L J E

F T E S Ë P Ë R O F E R T Ë

Për ekskursion te maturantëve të Shmlm „Luciano Motroni,, ne Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar(Agjensionet turistike organizatore te udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të Shmlm „Luciano Motroni,, nga Prizreni për në Rpublikën e Shqipërise me datë **02.05.2025** deri më **06.05.2025**

Paraqitësit në tender duhet ti plotësojnë këto kritere:

- Certifikatën e biznesit me informatë për biznesin.
- Vërtetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2024 ne origjinale.
- Vërtetimin e Administrates tatimore që nuk ka borgje për vitin 2024 ne origjinale.
- Licencen e transportit nderkombëtar „D,,
- Referencat rreth organizimit te ekskursioneve me maturantë për tri vitet e fundit: 2022,2023,2024
- Fotokopjet e librezave te autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli Teknik.
- Kopjen e sigurimit te autobuseve, patentë shoferë të vozitësve dhe licencat CPC të vozitësve.
- Autobusët të jenë komfor me klimë dhe në numër te mjaftueshëm për mbi 450 vende.
- Certifikatat mjekësore për vozitësit.
- Kompania te sigurojë mjekun(Certifikate pune dhe diplome te mjekut)
- Dëshmi për Hotelin e ofruar në Durrës (Konfirmim rezervimi) pa të drejtë eksluzive vetëm për një Kompani, por rezervimi te jetë për shkollën e mjekësisë „Luciano Motroni,, Prizren dhe me datë kur është lëshuar.
- Të prezantohet ambienti (Komoditeti) së paku me foto i Hotelit, nr. i tel. te pronarit dhe adresa.
- Hoteli të posedoj mbi 450 shtretër.
- Sistemimi i nxënësve në dhoma te jetë jo më shumë se 4 nxënës.
- Të prezantohet menyja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për 5 ditë qëndrimi.
- Të prezantoj Licencën e agjensionit të akreditimeve ushqimore ne vendqëndrimin e nxënësve.
- Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa e hyrjes sipas itinerarit te përcaktuar nga KDSH-ja
- Hoteli te posedoj sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehen dhe lejohen pijet alkoolike.
- Oferta për nxënës të liruar nga pagesa.
- Agjensioni te ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit se paku 200.000 euro.

Verejtje:Kompania turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet të siguroj nënshkrimet nga: Drejtori i shkolles, Kryetari i KDSH-se, kryetares se Këshillit të nxënësve, për përmbushjen e kushteve te përcaktuara sipas kriterëve te lartëcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

Ofertuesit e interesuar aplikacionin dhe itinerarin e udhëtimit mundë ti marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit ne Prizren.

Afati i paraqitjes në Tender është 7 ditë pune, nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni sipas UA 02/2016 me datën: **15.04.2025** në ora 16:00 (DKA) Prizren ku mundë të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i paraparë sipas UA do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga Kompanitë, ku do te bëhet vlerësimi i tyre. Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjensionet turistike që i kanë të kompletuar ofertat, kanë numër të mjaftueshëm autobusësh.

Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania turistike e përgjegjëshme me çmimin më te ulët te ofertës. Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Tree Solar” LLC Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Impiantin Fotovoltaik – Parku Solar Hybrid “Tree Solar” PV 85 MWp dhe Battery 20 MW në Smallushë, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.05.2025 në ora 10:00 në objektin e Komunës se Lipjanit, Rruga “Shqipëria” Lipjan, do të organizohet debat publik nga Kompania “Tree Solar”LLC Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Tree Solar”LLC Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor, – për Impiantin Fotovoltaik – Parku Solar Hybrid “Tree Solar” PV 85 MWp dhe Battery 20 MW në Smallushë, Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Allwood Group” shpk Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Objektin Industrial – Fabrikë për përpunimin e Drurit dhe Administratë, në Qylagë, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.05.2025 në ora 11:00 në objektin e Komunës se Lipjanit, Rruga “Shqipëria” Lipjan, do të organizohet debat publik nga Kompania “Allwood Group” shpk Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Allwood Group” shpk Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor, – për Objektin Industrial – Fabrikë për përpunimin e Drurit dhe Administratë, në Qylagë, Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

[illegible]

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

A large background image of a woman's legs, with a small yellow flower icon above the text 'Lume's Details'.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Salon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abirapa Teatrıt, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Mercom Company” shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Objektivin Afarist – Linjë për prodhimin e mobileve, depo përcjellëse dhe administratë, në Babush i Muhaxherëve, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.05.2025 në ora 10:00 në objektin e Komunës së Lipjanit, Rruga “Shqipëria” Lipjan, do të organizohet debat publik nga Kompania “Mercom Company” shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Mercom Company” shpk, Prishtinë, për Pëlqim Mjedisor, – për Objektin Afarist – Linjë për prodhimin e mobileve, depo përcjellëse dhe administratë, në Babush i Muhaxherëve, Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besim Dina B.I. N.SH. "B. DINA-Oxygen" shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811311753.
- Sellmedin Bazda shpall të humbur certifikatën e biznesit "Nafo Dekor" me nr. 811565491.
- Sellmedin Bazda shpall të humbur certifikatën e biznesit "Nafo Dekor" me nr. 811565491.
- Beqir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. I-VIII të shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazrek Has Prizren.
- Hevzi Latifi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës profesionale "Ymer Prizreni" Prizren.
- Hajrush Gashi shpall të pa vlefshme dëftesën e klasës 1 deri 9 të shkollës fillore "Bajram Curri" në Kurushë të Madhe.
- Demokrat Rizanaj shpall të pa vlefshme diplomën e shkollës së mesme "Gani Çavderbasha" në Prizren.
- Dila Sopjani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Zef Lushmarku" Fshati Vilezh.
- Arbër Lipoveci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Naim J Gashi, B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 811147463 të lëshuar nga ARBK.
- Gani Gashi B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Fiskal 811145219 të lëshuar nga ATK.
- Dulë Gjuraraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II të sh.f.m.u. "Shaban Gola" Lipavec KK Gjakovë.
- Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9
- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë paralele e ndarë në Ponošec.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L